

VENDIM
Nr. 546, datë 18.6.2015

PËR CAKTIMIN E FORMËS DHE TË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË
AKSIONEVE TË SHOQËRISË “INSIG”, SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr. 8334, datë 23.4.1998, “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjike”, të ndryshuar, të nenit 1, të ligjit nr. 8831, datë 22.11.2001, “Për pronësinë shtetërore në shoqërinë tregtare financiare me kapital tërësisht shtetëror”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikave 1 e 2, të kreut I, të vendimit nr. 529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare që zotërohen nga shteti”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Forma e privatizimit të paketës së aksioneve të shoqërisë “INSIG”, sh.a., të bëhet nëpërmjet procedurës “Tender i hapur”.

2. Formula e privatizimit të paketës së aksioneve të shoqërisë “INSIG”, sh.a., do të jetë shitja 100 % e paketës shtetërore.

3. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nxjerr urdhrin për fillimin e procedurës së privatizimit me tender të shoqërisë “INSIG”, sh.a., si dhe për përgatitjen e dokumentacionit të tenderit. Ky dokumentacion nuk do të jetë konfidencial.

4. Kriteret bazë për vlerësimin e ofertave për blerjen e 100 % të paketës shtetërore të shoqërisë “INSIG”, sh.a., të jenë, si më poshtë:

- a) Çmimi i ofruar 80 pikë;
- b) Plani i biznesit dhe cilësia teknike e propozimit 10 pikë;
- c) Cilësia e investitorit 10 pikë.

5. Depozita e garancisë së tenderit të jetë vlera fikse prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh.

6. Në zbatim të ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, për procedurat e privatizimit të shoqërisë “INSIG”, sh.a., dhe për kushtet e kontratës së shitjes me ofertuesin fitues të merren miratimet përkatëse nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

7. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në përputhje me ligjin nr. 9643, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, është autoriteti përgjegjës për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e vlerësuesit të aksioneve të shoqërisë “INSIG”, sh.a., me qëllim privatizimin.

8. Fondet për përballimin e shpenzimeve për realizimin e procedurës së përzgjedhjes së vlerësuesit të aksioneve të shoqërisë “INSIG”, sh.a., të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, miratuar për vitin 2015, zëri “Shpenzime operative”.

9. Shuma e prokuruar për realizimin e procedurës së përzgjedhjes së vlerësuesit të aksioneve të shoqërisë “INSIG”, sh.a., të rialokohet në buxhetin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, nga të ardhurat që do të përfitohen nga privatizimi i shoqërisë “INSIG”, sh.a.

10. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe “INSIG”, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama